

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7898
E premte, 4 tetor 2024
Çmimi 0.50 €

Reagim i KMDLNj-së
**Manipulimet e MPB-së
të Serbisë në
Gjykatën Speciale** | F. 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SARRAZIN: KA MUNGESË TË VULLNETIT POLITIK TË AUTORITETEVE TË KOSOVËS PËR TA THEMELUAR ASOCIACIONIN

 | F. 3

I dërguari gjerman për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka thënë, gjatë qëndrimit të tij në Prishtinë, se autoriteteve në Kosovë u mungon vullneti politik për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. "Mund të kuptoj se ky është një debat i rxehtë politik në Kosovë dhe se, ndoshta, për momentin vullneti politik, veçanërisht përballë zgjedhjeve, nuk është mjaftueshëm i fortë për të vazhduar realisht me këtë edhe për shkak të ngjarjeve në Banjskë dhe frikës rreth asaj se çfarë mund të sjellë ky Asociacion", ka thënë Sarrazin



**HARGREAVES: JEMI KRENARË
PËR ROLIN TONË NË FSK DHE
PËR PËRPARIMIN E SAJ** | F. 5

**KURTI FLET PËR TAKIMET
NË POLONI, NJË NDËR TEMAT
ISHTË SIGURIA** | F. 3

**BARNAT DIKUR TË SHUMËKËRKUARA,
SOT ME AFAT TË SKADUAR
NË BARNATOREN E QKUK-së** | F. 5

EKONOMI



**KOSOVA, PAS PRESIONIT TË
GJERMANISË, NË PRAG TË RIKTHIMIT
TË MALLRAVE NGA SERBIA** | F. 8

**RRETH 100 DREJTUES TË KOMPANIVE
LIDERE GJERMANE MARRIN
PJESË NË FORUMIN E DYTË
EKONOMIK GJERMANO-KOSOVAR** | F. 8

SPORT



**ZHEGROVA PASI LA NË HIJE
YJET E REALIT: DALLIMIN
E BËRI SHPIRTI I IKIPIT** | F. 10

**OSMANI
E PËRFAQËSON
KOSOVËN NË
SAMITIN E KRERËVE
SHTETËTORË TË
FRANKOFONISË** | F. 5



**HOXHAJ: PËR
KOSOVËN, NË KËTO
KOHË LUFTËRASH,
ËSHTË JETIKE
PËRKRAHJA E
PERËNDIMIT** | F. 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Komisioni Evropian s' do të jetë në gjendje ta nisë mandatin e ri më 1 nëntor

BRUKSEL, 3 TETOR - Presidentja e Parlamentit Evropian (PE), Roberta Metsola, ka njoftuar të mërkurën se seancat dëgjimore për kandidatët për anëtarë të Komisionit Evropian (KE) do të zhvillohen nga 4 deri më 12 nëntor, duke bërë që të shtyhet fillimi i mandatit të ri të këtij komisioni. Ky është vendimi i konferencës së presidentëve në Parlamentin Evropian, ku marrin pjesë shefat e grupeve partiake. Ky vendim i PE-së e bën të

pamundur zbatimin e planit të presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, që mandatin e dytë ta nisë më 1 nëntor, pas zgjedhjeve të qershorit në bllokun evropian. Shumë diplomatë dhe parlamentarë në Bruksel edhe më herët ishin shprehur se data 1 nëntor për nisjen e mandatit të ri të KE-së, që e ka përmendur Von der Leyen, ka qenë joreale dhe se ajo e kishte përmendur këtë datë "për të bërë presion" ndaj Parlamentit Evropian.

Kur të gjithë kandidatët ta marrin pëlqimin e komisioneve parlamentare, atëherë Parlamenti Evropian voton në një seancë plenare për tërë Komisionin Evropian. Në rast se ndonjë nga kandidatët nuk e merr pëlqimin, atëherë vendi nga i cili vjen duhet ta dërgojë një kandidat tjetër, i cili prapë duhet ta kalojë tërë procedurën e miratimit. Kjo do të shkaktoje vonesa të reja. Prandaj edhe 1 dhjetori si datë për nisjen e mandatit duket mjaft ambicioz, por jo edhe i pamundur.



Deputetët opozitarë djegin katër "manekinë" para Kuvendit të Shqipërisë

TIRANË, 3 TETOR - Paraditen e 3 tetorit para hyrjes së Kuvendit të Shqipërisë u regjistruan momente tensioni. Deputetët e Partisë Demokratike në opozitë vendosën para Kuvendit katër "manekinë" me imazhet e kryeministrit Edi Rama dhe deputetit, njëherësh ish-ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe vëllezërve të tyre, Osli Rama dhe Agron Xhafaj, të cilët opozita i akuzon për përfshirje kriminale. Më pas, deputetët e opozitës hodhën benzinë dhe u vunë flakën katër "manekinëve", që i kishin veshur me "uniforma burgu". Punonjësit zjarrfikës ndërhyjnë duke shuar zjarrin. Ndërkaq, në



pritje të nisjes së seancës plenare, punonjësit e Gardës së Republikës mbyllën dyert për 24 deputetët e

opozitës të përjashtuar përkohësisht nga punimet plenare.

Sekretariati i Etikës i Kuvendit të Shqipërisë vendosi të mërkurën përjashtimin përkohësisht për 24 deputetë të opozitës nga seancat plenare të Kuvendit për shkak se dogjën karrige para ndërtesës së institucionit tri ditë më parë. Sekretariati vendosi - që kreu i grupit parlamentar i PD-së, Gazmend Bardhi, bashkë me sekretarin e përgjithshëm të kësaj partie, Flamur Noka, dhe deputetin Bledion Nallbati - të përjashtohen për 60 ditë nga seancat plenare secili. Ndërsa 20 deputetë të tjerë janë përjashtuar për 40 ditë. Një deputet tjetër është përjashtuar për 10 ditë nga seancat.

Vendimi ka hyrë në fuqi të enjten, kur Kuvendi duhej ta zhvillonte seancën e radhës. Deputetët e opozitës u përpoqën ta kalonin kordonin e sigurisë dhe kishte edhe konfrontime fizike, por nuk u lejuan të hynin në sallë. Disa deputetë demokratë nuk lejuan as ministrin e Financave, Petrit Malaj, të hynte në sallën e Kuvendit. Për shkak të kësaj situatë nuk morën dot pjesë në punimet e Kuvendit as deputetët e opozitës, ndaj të cilëve nuk ka masë disiplinore. Kreu i grupit parlamentar i PD-së, Gazmend Bardhi, deklaroi se aksioni i opozitës do të vijojë dhe se nuk do të ketë zhvillim normal të seancave plenare.

Lufta i kushton Izraelit 100 miliardë dollarë



JERUSALEM, 3 TETOR - Lufta kushton. Shumë madje. Jo vetëm nga pikëpamja njerëzore. Konflikti në Lindjen e Mesme po paraqet një kosto shumë të lartë për Izraelin, i cili, ndër të tjera, është i angazhuar në shumë fronte. Fillimi i operacioneve në Liban dhe konflikti tashmë i hapur me Iranin vetëm sa do të rrisë më tej shpenzimet pas asaj që ndodhi në Gaza. Ekonomistët izraelitë kanë bërë llogaritjet: "kostot aktuale variojnë midis 67 miliardë dollarë (vlerësuar nga Banka Qendrore

izraelite) dhe 120 miliardë dollarë. Në gusht, Banka Qendrore izraelite bëri një vlerësim të parë të kostonë së konfliktit për Izraelin midis 2023 dhe 2025 në 67 miliardë dollarë (nga të cilat 32 miliardë vetëm për shpenzimet ushtarake), e barabartë me pothuajse 13 % të prodhimit brendshëm bruto (PBB) të vendit. Kësaj shifre iu shtuan edhe kostot 10 miliardë dollarë për ta financuar transferimin e afërsisht të 100 mijë izraelitëve, të cilët duhej t'i linin shtëpitë e tyre pranë Rripit të Gazës

ose kufirit me Libanin, pasi ishin shënjestruar nga raketat e Hamasit dhe Hezbollahut. Shumë e lartë është edhe kostoja me të cilën duhet të përballet Izraeli për ta mbrojtur territorin me dronë inteligjentë. Kompania "Iron Dome", që ka garantuar se arrin të rrezojë jo më pak se 90 % të raketave që hyjnë në territor, ka një çmim prej 50 mijë dollarësh për çdo kundër-raketë që lëshon ndaj sulmeve dhe prej 2011-s, shpenzimet kanë shkuar afërsisht 3.5 miliardë dollarë.

ShBA, kusht për mbështetjen ndaj Izraelit, Biden: Jo sulme ndaj objekteve bërthamore të Iranit

UASHINGTON, 3 TETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara Joe Biden, tha se ai nuk do të mbështeste asnjë sulm izraelit në objektet dhe qendrat bërthamore të Iranit, në përgjigje të sulmit të Teheranit dhe i bëri thirrje Izraelit të reagojë në mënyrë "proporcionale". Presidenti Biden foli një ditë pasi Irani sulmoi me 180 raketa

balistike Izraelin dhe kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu është zotuar se Irani do të paguajë për sulmin. "Ne do të diskutojmë me izraelitët se çfarë do të bëjnë, por vendet e G7-s bien dakord se Izraeli ka të drejtë të përgjigjet, por duhet të përgjigjet proporcionalisht", u tha presidenti Biden gazetarëve.

I pyetur nëse ai do ta mbështeste Izraelin për t'i goditur objektet bërthamore iraniane siç ka kërcënuar prej kohësh, presidenti Biden u tha gazetarëve se "përgjigja është jo". Bideni tha se duhet të vendosen sanksione të tjera ndaj Iranit dhe ai do të zhvillonte një bisedë me kryeministrin Netanyahu, së shpejti.



Limaj publikon fotografi me mbesat, nipërit dhe bashkëmohatarët e tyre

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka publikuar në "Facebook" disa fotografi me mbesat, nipërit dhe bashkëmohatarët e tyre. Limaj ka thënë se është mrekulli e fat çdo minutë që kalojmë me të vegjlit tanë. "Një ditë e veçantë

me mbesat, nipërit dhe bashkëmohatarët e tyre, të cilët janë bekimi më i madh, me të cilin Zoti na lumturon si gjithë, prindër, familje dhe si shoqëri në përgjithësi. Është mrekulli e fat çdo minutë që kalojmë me të vegjlit tanë, sepse, sa më shumë pranë tyre,

aq më tepër motiv për punën e jetën, aq më shumë kuptim për lirinë që gëzojmë, dhe aq më shumë nder e respekt për sakrificën e shumë brezave. Gjithë fëmijët në vendin tonë, do Zoti të rriten me shëndet e të bëhen krenaria e kombit", ka shkruar Limaj.



Sarrazin: Ka mungesë të vullnetit politik të autoriteteve të Kosovës për ta themeluar Asociacionin

I dërguari gjerman për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka thënë, gjatë qëndrimit të tij në Prishtinë, se autoriteteve në Kosovë u mungon vullneti politik për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. "Mund të kuptoj se ky është një debat i nxehtë politik në Kosovë dhe se, ndoshta, për momentin vullneti politik, veçanërisht përballë zgjedhjeve, nuk është mjaftueshëm i fortë për të vazhduar realisht me këtë edhe për shkak të ngjarjeve në Banjskë dhe frikës rreth asaj se çfarë mund të sjellë ky Asociacion", ka thënë Sarrazin

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 TETOR - I dërguari gjerman për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, tha se autoriteteve në Kosovë u mungon vullneti politik për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, posaçërisht në një kohë kur vendi ndodhet në prag të zgjedhjeve të reja parlamentare. Ai i bëri këto komente në Prishtinë, gjatë një debati lidhur me angazhimin gjerman gjatë 25 vjetëve të fundit në Kosovë. "Dhe sinqerisht, mund të kuptoj se ky është një debat i nxehtë politik në Kosovë dhe se, ndoshta, për momentin vullneti politik, veçanërisht përballë zgjedhjeve, nuk është mjaftueshëm i fortë për të vazhduar realisht me këtë edhe për shkak të ngjarjeve në Banjskë dhe shumë gjëra të tjera, si dhe frikës rreth asaj se çfarë mund të sjellë ky Asociacion", tha ai. Kosova dhe Serbia janë pajtuar për

një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve, por zbatimi i saj ende nuk ka filluar. Në tetorin e vitit të kaluar zyrtarët më të lartë evropianë i kërkuan Kosovës themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa Serbisë përmbushjen e pjesëve të marrëveshjes që çojnë në njohjen 'de facto' të Kosovës.

Të dyja palët e kanë akuzuar njëra-tjetrën për mospërmbushje të marrëveshjes.

Sarrazin tha se Bashkimi Evropian po ndjek planin e zbatimit të marrëveshjes të arritur në Ohër dhe se, sipas tij, hapi tjetër është paraqitja e projekt-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Dhe, sinqerisht, duke e dërguar në Gjykatën Kushtetuese, është një ofertë për Kosovën sepse ka pasur reagime se mund të mos jetë në përputhje plotësisht me Kushtetutën e Kosovës. Ne kemi thënë në rregull, pra, le të sigurohemi që një proces të jetë në përputhje me



Kushtetutën e Kosovës. Kështu që unë mendoj se është e qartë se ne mund të kemi shumë argumente teorike dhe argumente teknike, projekt-statuti e gjëra të tjera por, në fund, bëhet fjalë për vullnetin politik për të vazhduar realisht me themelimin e Asociacionit", tha ai. Donika Emini, hulumtuese dhe eksperte e sigurisë, tha se dialogu në Bruksel është rrëmbyer

plotësisht dhe nëse nuk ndryshon shteteve anëtare, ky proces nuk do të çojë askund. Ajo kritikoi përpjekjet e zyrtarëve perëndimorë që të kanalizojnë gjithçka përmes Asociacionit të Komunave Serbe. "Ju flisni për viza, çështje krejtësisht teknike. Tajvani e ka atë. Përmendët Asociacioni. Pastaj dialogu dhe plani i rritjes,

prapë Asociacioni dhe pastaj ju flisni për procesin e Berlinit, ndoshta Asociacioni. Përpjekja për të vënë gjithçka në deponinë e dialogut të Brukselit po bëhet vërtet e dëmshme për Kosovën. Dhe kjo në thelb çon në të gjitha këto, si mungesa e komunikimit dhe madje në tensionet diplomatike midis vendeve. Nuk mund ta përdorni", tha ajo.

Kurti flet për takimet në Poloni, një ndër temat ishte siguria

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe shefin e misionit tonë në Poloni, ambasadorin Drilon Gashi, ka realizuar disa takime që në fokus kishin çështjet e sigurisë, mbrojtjes, sundimit të ligjit, digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike, në kuadër të ditës së dytë të Forumit për Siguri të Varshavës. "Takua

zëvendëskryeministrin e Polonisë, Krzysztof Gawkowski dhe ministrin e Drejtësisë, Adam Bodnar, ministrin e Mbrojtjes të Estonisë, Hanno Pevkur, ambasadorin e Austrisë në Poloni e ish-ministrin e Mbrojtjes të Austrisë, dr. Werner Fasslabend, Andreas Stadler, dhe drejtorin e Fondacionit 'Casimir Pulaski', Zbigniew Pisarski, si dhe me publicistin e njohur polak

dhe kryeredaktorin e gazetës 'Wyborcza', Adam Michnik. Mbrëmjen e përmblyëm me një pritje të organizuar për diasporën tonë në Poloni. Poloninë e kemi shtet mik për shumë vite. Na ka mbështetur ndër vite. Me hapjen e Misionit të Kosovës në Poloni sivjet, po zgjerojmë dhe forcojmë partneritetin ndërmjet dy shteteve dhe popujve tanë", ka shkruar Kurti në "Facebook".





Hoxhaj: Për Kosovën në këto kohë luftërash është jetike përkrahja e Perëndimit

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 TETOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka marrë pjesë dhe ishte pjesë e panelit në konferencën "Ndikimi i agresionit rus në Ukrainë në gjeopolitikën evropiane", organizuar në Prishtinë nga Instituti OCTOPUS. Ai ka theksuar se për Kosovën, në këto kohë luftërash, është jetike përkrahja e Perëndimit.

Hoxhaj ka thënë se paqja ishte normë dhe lufta u pa si një lajthitje për një kohë të gjatë në Evropë. "Me luftën në Ukrainë dhe në Lindje të Mesme, lufta është bërë mjerisht pashmangshme e kohës sonë! Një kohë kemi besuar në pabesueshmërinë e luftës, sot mjerisht mund të flitet për pashmangshmërinë e saj! Kjo tregon për kohën në të cilën jetojmë, që është jo vetëm e pasigurt dhe e turbullt, por tërësisht e paparashikueshme! Kjo sot është e qartë sapo të lexojmë lajme për sulmet e padrejta të Iranit kundër Izraelit, për luftën në Gaza, por edhe për luftën në Ukrainë. Një gjë është e duhur dhe e drejtë: që lufta në Ukrainë e rizgjo

gjeopolitikisht Perëndimin, duke u shndërruar në një mbështetje politike, diplomatike, ushtarake dhe ekonomike! Kam pritje edhe më shumë mbështetje perëndimore për Ukrainën, gjë që shpresoj ta shoh pas zgjedhjeve në ShBA, të cilat do të nxjerrin një Amerikë më të fortë pas pak javësh! Këtë e pres edhe me Komisionin e ri Evropian, por edhe me një Gjermani më të fortë vitin e ardhshëm, pas zgjedhjeve atje!", ka thënë Hoxhaj.

Por, sipas tij, një gjë është e rrezikshme: që lufta në Ukrainë u përdor edhe për rizgjimin e ambicieve hegjemoniste në Ballkan, duke theksuar se problemi më i madh që ka rajoni është hegjemonia serbe dhe kërcënimet ndaj Kosovës, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës. "Serbia vazhdon t'i ndjekë ambiciet hegjemoniste në Ballkan, duke sfiduar sovranitetin e Kosovës, Malit të Zi dhe Bosnjës përmes ndërhyrjeve politike, përpjekjeve destabilizuese, luftës hibride dhe mbështetjes për grupet radikale dhe kriminale në këto vende. Grupet kriminale dhe paramilitare ishin ato që synuan që të bënin puç kundër qeverisë malazeze, ngjashëm me agresionin në

Banjskë vitin e kaluar më mbështetje të shumfifshite të Serbisë. Një problem tjetër që është i ndërlidhur me të parin, është politika perëndimore e përkëdheljes së Serbisë", është shprehur ai, duke shtuar se qasja e Perëndimit, shpesh duke favorizuar zbutjen e Serbisë, nuk arrin të përballet me këto veprime destabilizuese. "Kjo politikë inkurajon sjelljen agresive të Serbisë duke minuar sovranitetin e fituar me vështirësi të Kosovës, por edhe atë të Malit të Zi dhe të Bosnjës! Perëndimi ka ndërtuar një rend evropian në Ballkan me hartën e shteteve të pavarura, ku Mali i Zi në 2006 dhe Kosova në 2008 ishin të fundit, duke ndjekur një politikë të parimeve dhe të vijave të kuqe! Ku janë sot vijat e kuqe të perëndimit për Serbinë?", ka pohuar ish-ministri i jashtëm.

Hoxhaj ka thënë se një çështje tjetër që e kemi në Ballkan është politika e status-quo, e cila çon në degradim politik e assesit në përparim. "Kjo ka të bëjë me ndikimin që ka mosveprimi i BE-së dhe NATO-s: Mungesa e zgjerimit konkret të BE-së dhe mungesa e anëtarësimit në NATO për Kosovën dhe shtetet e tjera të Ballkanit kanë krijuar një vakum sigurie. Kjo ka lejuar fuqitë e jashtme si Rusia të

ushtrjnë ndikim dhe të destabilizojnë më tej rajonin, e cila sot është më e madhe se sa është menduar kur ka filluar lufta në Ukrainë. Sot, Serbia sillet në Ballkan ndaj fqinjëve të tyre njëjtë sikurse Rusia, me të vetmin dallim që Serbia është sa bastion i ndikimit rus, po aq zgjatje e Ruisë në rajon! Meqë ndërhyrja ruse në Ballkan, duke përdorur Serbinë si një përfaqësues, mbetet një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë, duke promovuar narrativat antiperëndimore dhe duke nxitur tensionet etnike, këtë çështje mund adresohen përmes një politike të strukturuar! Një politikë e tillë duhet të jetë një vazhdimësi e forcimit të shtetësisë së Kosovës përmes njohjes së plotë ndërkombëtare dhe anëtarësimit në NATO, të cilat thelbësor për ruajtjen e sigurisë rajonale dhe për t'iu kundërvënë kërcënimeve të jashtme, veçanërisht në dritën e sfidave të sigurisë në zhvillim të Evropës. Për forcim të shtetësisë kanë nevojë edhe Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia Veriore!", ka thënë Hoxhaj. Ai ka shtuar se meqë integrimi evropian ka ngecur dhe Kosova përballet me mungesë të përparimit thelbësor në integrimin në BE dhe reformat e

tjera kyçe të ngecura, po ndodh një zhgënjim gjithnjë më i madh politik, stagnim ekonomik edhe më i dukshëm dhe migrim gjithnjë më masiv i rinisë drejt BE-së, por edhe vendeve të tjera perëndimore. "Agresioni rus ndaj Ukrainës ka ekspozuar dobësitë në arkitekturën e sigurisë së Evropës, por BE sot ka nevojë ta vë edhe më shumë si prioritet dhe domosdoshmëri për një integrim më të madh të Ballkanit Perëndimor në NATO dhe BE për të parandaluar agresione të ngjashme. Për Kosovën dhe për shtetet e tjera, bashkëpunimi dhe qëndrueshmëria rajonale janë të rëndësishme. Është një nevojë urgjente për një bashkëpunim më të madh rajonal dhe ndërtim të qëndrueshmërisë midis shteteve pro-Ballkanit Perëndimor për t'iu kundërvënë këtyre forcave destabilizuese dhe për ta mbrojtur sovranitetin dhe stabilitetin e rajonit! Për Kosovën është me rëndësi që ta marrim jo vetëm përkrahjen e Perëndimit, gjë që është jetike, por edhe mbështetjen publike të popujve në rajon, për karakterin dhe natyrën e shtetësisë së Kosovës, për integritetin territorial, sovranitetin, demokracinë dhe natyrën multietnike dhe unitare të Kosovës", ka theksuar Hoxhaj.

Osmani e përfaqëson Kosovën në samitin e krerëve shtetërorë të Frankofonisë

PARIS, 3 TETOR - Me ftesë të Prokurorit të Specializuar në Hagë ishte Stamenka Jelliq që dëshmoi për marrjen e burrit të saj nga persona të pidentifikuar e që përgjegjësia për këtë i adresohet UÇK-së, gjithnjë sipas ZPS-së e që mbështetet në faktet e sajura nga institucionet hetuese dhe të sigurisë së Serbisë. Këtë e vërtetoi dëshmitarja Jelliq, që ndryshe është dëshmitarja e 94-të e ZPS-së.

Ajo, gjatë dëshmisë deklaroi se në dëshminë që e ka dhënë para autoriteteve serbe nuk ka përmendur asnjë emër të përvetshëm sikur që nuk ka dhënë asnjë indikacion për rrëmbyesit e mundshëm të burrit të saj. Deklaratën e ka nënshkruar në formën dhe përmbajtjen që e ka dhënë kurse kjo në të cilën mbështetet prokurori special nuk është e saj por se është sajuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë duke përmendur emra

Paris. Ajo do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në samitin e krerëve të shteteve të kësaj organizate. Gjatë qëndrimit në Paris, presidentja Osmani do të ketë adresim në një nga seancat e Frankofonisë, gjersa do të

takojë edhe homologë. Presidentja dhe Zotëria i Parë janë ftuar në darkën zyrtare të shtruar nga presidenti Macron në Pallatin Élysée, në drekën zyrtare të shtruar nga sekretarja e përgjithshme e Frankofonisë, si dhe në një

sërë aktiviteteve përcjellëse në kuadër të Samitit. Ky samit mbledh krerët e shteteve anëtare, anëtarë të asociuar, anëtarë vëzhgues, përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe të ftuar të tjerë.



Reagim i KMDLNj-së

Manipulimet e MPB-së të Serbisë në Gjykatën Speciale

Si dëshmitare e Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë ishte Stamenka Jelliq që dëshmoi për marrjen e burrit të saj nga persona të pidentifikuar e që përgjegjësia për këtë i adresohet UÇK-së, gjithnjë sipas ZPS-së e që mbështetet në faktet e sajura nga institucionet hetuese dhe të sigurisë së Serbisë. Këtë e vërtetoi dëshmitarja Jelliq, që ndryshe është dëshmitarja e 94-të e ZPS-së.

që për dëshmitaren janë të panjohur. KMDLNj-ja gjithmonë ka deklaruar se provat e ZPS kundër udhëheqësve ushtarakë dhe politikë, të gjithë shqiptarë dhe shtetas të Kosovës janë kryesisht nga intelijenca dhe institucionet e Serbisë të cilët, me ndihmën e disa mercenarëve të Kosovës kanë trajnuar dëshmitarë nga Kosova dhe Serbia se si të dëshmojnë para kësaj gjykate. Dëshmitarja Jelliq dhe dëshmitarë tjerë e kanë vërtetuar këtë pakundërshtueshëm. Për këtë arsye KMDLNj ka kërkuar që ky proces të monitorohet nga organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në kohën kur Kosovës i mohohet kjo e drejtë dhe kjo mundësi. Procesi që nuk monitorohet nga monitorues të pavarur dhe që nuk i nënshtrohet transparencës dhe llogaridhënies domosdoshmërisht e pamundëson një gjykim të drejtë,



të paanshëm dhe të pandikuar nga politika dhe grupet e interesit. Pa asnjë dyshim bie në kundërshtim me të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria. Ndërkaq gjykimi para

Gjykatës Speciale në mënyrë flagrante shkelë të drejtat e njeriut pasi ua mohon të gjitha të drejtat të privuarve nga liria. Shtrohet një pyetje logjike dhe praktike: kush po i dënon shtetasit e Kosovës,

"sipas ligjeve të Kosovës", Haga apo Serbia. Apo, të dyja bashkë, me një bashkëpunim që brutalisht dhuron të drejtën ndërkombëtare duke sajuar prova!

Hargreaves: Jemi krenarë për rolin tonë në FSK dhe për përparimin e saj



PRISHTINË, 3 TETOR - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Jonathan Hargreaves, ka thënë se vendi i tij është krenar për arritjet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe për rolin që ka dhënë për këtë. Ai ka thënë se FSK-ja është profesionale, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse. "Britania e Madhe është krenare për rolin që ka pasur në progresin e FSK-së

drejt të qenit e aftë, profesionale, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse. Dje e përgëzova FSK-në për mbledhjen vjetore të miqve dhe partnerëve ndërkombëtarë të përkushtuar në aspiratën e FSK-së për të ofruar siguri në Kosovë dhe Evropë", ka shkruar Hargreaves në "Facebook". Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja të mërkurën kanë mbajtur

konferencën vjetore ndërkombëtare "FSK dhe Partnerët 2024". Në këtë konferencë kanë marrë pjesë përfaqësues të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, ambasadorë, atashe të mbrojtjes të Republikës së Kosovës, si dhe përfaqësues të tjerë diplomatikë dhe atashetë ushtarakë të të gjitha shteteve partnere të Republikës së Kosovës.

Ortopedia bëhet me klinikë të re, Vitia: Janë investuar 2.5 milionë euro

PRISHTINË, 3 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, kanë përfunduar Klinikën e re të Ortopedisë. Fillimisht, Vitia dhe Azizi kanë vizituar dhomat dhe sallat operative të kësaj Klinike, me ç'rast është bërë me dije se kostoja totale e investimit është 2.5 milionë euro, ku janë rinovuar 3 500 metra katrorë me 22 dhoma dhe 44 shtretër. "Përfundim këtu klinikë moderne prej 3 500 metra katrorë, me 22 dhoma dhe 44 shtretër, që do të

thotë se nga dy pacientë nëpër dhoma. Dhomat janë me klimatizim, me mekanizëm të thirrjes së infermierëve dhe mjekëve. Me komplet pjesën digjitale e cila do të mundësojë edhe për pjesën operative se si dhe çfarë është duke u bërë dhe cili mjek është duke operuar. Jam i lumtur që kjo klinikë me 2.5 milionë euro po hapet e që është në shërbim të pacientëve", ka thënë Vitia, duke shtuar se do të vazhdojnë të investojnë në spitalet regjionale. "Shumë

shpejt do të fillojmë në spitalet regjionale në mënyrë që pacientët nga regjionet e tjera të kenë mundësi të njëjtat shërbime t'i marrin afër qytetarëve të tyre në mënyrë që mos të ketë nevojë të bëhen tollovi, që nganjëherë bëhet në QKUK për shkak të mungesës së këtyre shërbimeve", ka thënë Vitia. Ndërsa drejtori i Klinikës së Ortopedisë, Xhavit Gashi, ka thënë se zhvendosja e pacientëve do të bëhet nga java e ardhshme. "Puna në



blokun operativ veçse është duke u punuar, ndërsa zhvendosja e pacientëve në

pjesën e vjetër të Klinikës Kirurgjisë do të bëhet në javën tjetër", ka thënë Gashi.

Instituti i së Drejtës së Vetëvendosjes sipas së drejtës ndërkombëtare në përgjithësi dhe në veçanti për popullin shqiptar



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Instituti i së Drejtës së Vetëvendosjes së Popujve në të Drejtën Ndërkombëtare është një nga parimet themelore të rendit ndërkombëtar dhe mbrojtës i të drejtave të popujve për të përcaktuar statusin e tyre politik dhe rrugën e tyre ekonomike, sociale dhe kulturore pa ndërhyrje të jashtme. Ky koncept është i rënjosur në dokumente ndërkombëtare kyçe, si Kartat e Kombeve të Bashkuara, dhe është forcuar nëpërmjet praktikës së shteteve dhe vendimeve të gjykatave ndërkombëtare.

Origjina dhe Zhvillimi i Parimit të Vetëvendosjes: Parimi i vetëvendosjes rrjedh nga periudha e Luftës së Parë Botërore dhe përmendet për herë të parë në mënyrë të qartë nga presidenti i ShBA-së, Woodrow Wilson, në 14 Pikat e tij të vitit 1918. Ai i dha popujve të perandorive të shpërbëra të drejtën për të vendosur mbi fatin e tyre politik. Wilson propozoi që kombet e vogla të Ballkanit dhe Evropës Lindore të kishin mundësinë të zgjedhin qeveritë e tyre, si një hap drejt stabilitetit dhe paqes.

Traktati i Versajës që pasoi Luftën e Parë Botërore nxori në pah zbatimin e kufizuar të këtij parimi,

duke lënë shumë popuj, si shqiptarët dhe kurdët, në kushte të vështira nën sundimin e shteteve të tjera. Megjithatë, koncepti i vetëvendosjes evoluoi si një parim i njohur për të gjitha kombet që aspironin pavarësinë.

Lufta e Dytë Botërore forcoi zbatimin e këtij parimi: Kartat e Kombeve të Bashkuara, e miratuar në vitin 1945, në Nenin 1(2) thekson se një nga qëllimet e organizatës është "zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve, bazuar në respektimin e parimit të barazisë së të drejtave të popujve dhe vetëvendosjes së tyre". Kjo vendosi një bazë ligjore të qartë për të drejtën e popujve për vetëvendosje.

Dekolonizimi dhe Vetëvendosja: Një nga fushat më të rëndësishme të zbatimit të vetëvendosjes në të drejtën ndërkombëtare ishte procesi i dekolonizimit pas Luftës së Dytë Botërore. Rezoluta 1514 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi Dhënien e Pavarësisë Shteteve dhe Popujve Kolonialë, e miratuar më 14 dhjetor 1960, theksoi të drejtën e popujve të territoreve koloniale për të vendosur vetë për të ardhmen e tyre. Kjo rezolutë nënvizoi që të gjitha popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes; përmes kësaj të drejte, ata vendosin lirshëm statusin e tyre politik dhe ndjekin zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor.

Pavarësia e Algjerisë nga Franca në vitin 1962, pas një lufte të përgjakshme çlirimtare, është një nga shembujt më të spikatur të zbatimit të parimit të vetëvendosjes në kontekstin e dekolonizimit. Algjeria, që për dekada ishte përbërës me represion të ashpër dhe një regjim kolonial që e konsideronte si pjesë

të integruar të Francës, arriti të fitojë pavarësinë përmes rezistencës kombëtare dhe mbështetjes ndërkombëtare. Një shembull tjetër është pavarësia e Namibisë në vitin 1990, pas dekadash sundimi nga Afrika e Jugut nën regjimin e apartheidit. Këshilli i Sigurimit i OKB-së, përmes një mori rezolutash dhe ndërhyrjes ndërkombëtare, luajti një rol kyç në njohjen e së drejtës së popullit të Namibisë për vetëvendosje, çka çoi në fundin e sundimit kolonial dhe lindjen e një shteti të pavarur.

Vetëvendosja e Popujve Evropianë: Shembulli i Kosovës. Një nga rastet më të debatueshme të zbatimit të parimit të vetëvendosjes në shekullin e XX është rasti i Kosovës. Me një shumicë dërrmuese shqiptare, Kosova për dekada të tëra ishte objekt i represionit serb dhe synoi pavarësinë nga Jugosllavia dhe më pas nga Serbia. Konflikti arriti kulmin në fund të viteve 1990 me Luftën e Kosovës (1998-1999) dhe përfundoi me ndërhyrjen e NATO-s në mars të vitit 1999. Pas përfundimit të luftës, Kosova u vu nën administrimin e përkohshëm të OKB-së përmes Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, por aspiratat e popullit shqiptar për vetëvendosje vazhduan. Pas një periudhe të gjatë të bisedimeve të ndërmjetësuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe pas dështimit të negociatave me Serbinë, Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në vitin 2010, në një opinion këshillues, vërtetoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk shkelte të drejtën ndërkombëtare. Ky konstatim këshillues konfirmoi se akti i shpalljes së pavarësisë ishte i

ligjshëm sipas së drejtës ndërkombëtare dhe se Kosova kishte të drejtën për vetëvendosje në rrethanat e dhunës dhe diskriminimit sistematik të ushtruar ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Sot Kosova është njohur nga mbi 100 shtete, përfshirë shumicën e vendeve të BE-së dhe ShBA-në. Megjithatë, Serbia, si dhe disa vende të tjera, refuzojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës, duke theksuar të drejtën e integritetit territorial. Kjo çështje mbetet një pikë e rëndësishme e debateve ndërkombëtare, veçanërisht në dialogun Kosovë-Serbi të ndërmjetësuar nga BE-ja.

Aspiratat e Shqiptarëve për Vetëvendosje: Rasti i Shqipërisë dhe Territorit të Çamërisë. Gjatë shekullit XX, shqiptarët kanë ndjekur rrugë të ndryshme për realizimin e të drejtës së tyre për vetëvendosje, jo vetëm në Kosovë, por edhe në territoret shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme.

Konferenca e Londrës në vitin 1913, që ndau trojet shqiptare, ka krijuar probleme të pazgjidhura për shqiptarët që kanë mbetur në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbi dhe Greqi. Çështja e Çamërisë përbën një nga episodet më të dhimbshme të historisë shqiptare. Pas Luftës së Dytë Botërore, mijëra shqiptarë etnikë të Çamërisë u dëbuan nga territori i Greqisë në një akt që shumë e kanë quajtur spastrim etnik. Shqiptarët çamë kërkojnë njohjen e të drejtave të tyre për kthim dhe kompensim për humbjet e tyre, një kërkesë që ende përballet me rezistencë nga Greqia. Vetëvendosja dhe Integrimi Evropian: Integrimi i Shqipërisë dhe Kosovës në Bashkimin Evropian dhe NATO shihet si një

faktor kyç në stabilizimin dhe realizimin e aspiratave kombëtare për vetëvendosje. Shqipëria u bë anëtare e NATO-s në vitin 2009 dhe ka përparuar në procesin e integritetit në BE, ndërsa Kosova po vazhdon përpjekjet për të forcuar pozitën e saj ndërkombëtare dhe për të përfunduar nga mbështetja e organizatave ndërkombëtare.

Shqipëria dhe Kosova po përballen me sfida të ndryshme për t'i përmbushur kriteret e nevojshme për t'u integruar në Bashkimin Evropian (BE). Kriteret kryesore që ato duhet të plotësojnë përfshijnë forcimin e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, reformat në drejtësi dhe administratë publike, dhe përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave. Në Shqipëri përpjekjet më të mëdha janë vërejtur në procesin e reformës në drejtësi, që ka qenë një nga prioritetet e BE-së. Megjithatë, korrupsioni mbetet një pengesë e rëndësishme për progresin më të shpejtë drejt antarësimit. Nga ana tjetër, Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm me çështjen e liberalizimit të vizave nga BE, por ende përballet me sfida të mëdha në forcimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit dhe marrëdhëniet me Serbinë. Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është një kërkesë kyçe për avancimin e Kosovës në rrugën drejt BE-së, ndërsa BE-ja luan rolin e ndërmjetësimit në këtë proces. Të dyja vendet duhet t'i vazhdojnë reformat e brendshme për t'i përmbushur standardet e BE-së, ndërkohë që përballen me sfida të brendshme dhe të jashtme në këtë proces të ndërlikuar.

Sulmohet prona e ish-kryetarit të Zubin Potokut

ZUBIN POTOK, 3 TETOR - Një objekt banimi, në ndërtim e sipër, pronë e ish-kryetarit të komunës së Zubin Potokut, Stevan Vulloviq, është sulmuar pas mesnatës. Kështu tha kreu aktual i kësaj komune, Izmir Zeqiri, i cili e dënoi shpërthimin.

Zeqiri i tha Radios Evropa e Lirë se dyshon se sulmi ndaj objektit të Vulloviqit ndodhi pasi ai ishte takuar me të në një kafene në Zubin Potok disa ditë më parë. "Ka qenë shumë takim shoqëror, takim i rastit. Kemi pirë nga një kafe, kemi biseduar si ish-kryetar që ka qenë. Kemi biseduar natyrisht edhe për interesin qytetar", tha Zeqiri.

Zeqiri shtoi se pret që ta takojë sërish Vulloviqin në mundësinë e parë që do ta ketë për ta ngushëlluar lidhur me këtë ngjarje. "Këto gjëra janë shumë të papranueshme. Unë do të bisedoj edhe me organet e sigurisë. Brenda tre muajve është sulmi i katërt që

po ndodh ndaj aktorëve dhe bashkëpunëtorëve të mi", shtoi Zeqiri.

Radio Evropa e Lirë deri më tani e ka pasur të pamundur të kontaktojë me Vulloviqin.

Stevan Vulloviq ishte kryetar i Zubin Potokut nga Lista Serbe nga viti 2013 deri më 2018, kur dha dorëheqje së bashku me kryetarët e tjerë të komunave në veri të Kosovës, pasi Qeveria e Kosovës, që udhëhiqej nga Ramush Haradinaj, vendosi taksën prej 100-përqindësh ndaj importeve të mallrave nga Serbia. Atëbotë ai kishte deklaruar se ishte jashtëzakonisht i lumtur që kishte dhënë dorëheqje sepse "e kam bartur barrën e të qenët kryetar i institucioneve të Kosovës".

Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha për Radion Evropa e Lirë se policia doli në vendin e ngjarjes pas shpërthimit. Ai tha se



në objektin banesor, që është në ndërtim e sipër, shpërtheu zjarr, duke shtuar se nga kjo ngjarje nuk ka të lënduar.

Policia e Kosovës tha se ende nuk e di shkakun e këtij shpërthimi. Të shtunën, më 28 shtator, në veriun e Kosovës të banuar me

shumicë serbe ndodhi po ashtu një shpërthim, pasi në Zveçan u hodh një mjet shpërthyes në afërsi të një pike karburanti.

Barnat dikur të shumëkërkuara, tani me afat të skaduar në barnatoren e QKUK-së

Prishtinë, 3 tetor - Në kulmin e pandemisë Covid-19, në vitet 2020 dhe 2021, ilaçi Remdesivir vështirë mund të gjendej në Kosovë, ose duhej të paguhej qindra euro.

Sot mijëra pako të tij, me afat të skaduar, gjenden në Barnatoren Qendrore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). “Unë nuk kam qenë këtu atëkohë, por është një dhomë me produktin Remdesivir, me rreth 7 mijë njësi”, thotë për Radion Evropa e Lirë drejtoresha e kësaj barnatoreje, Dardane Mehaj.

Barnatorja Qendrore e QKUK-së furnizon të gjitha barnatoret e klinikave të saj, ndërsa për çështjen e barnave koordinohet edhe me spitalet rajonale.

Ekipi i REL-it e vizitoi atë në fund të shtatorit, ku pa disa dhoma me barna me afat të skaduar, të vendosura shumë pranë barnave të përdorshme - me vetëm një perde në mes.

Pavarësisht kësaj gjendjeje, Mehaj siguron se barnat e përdorshme janë të sigurta. Ndërsa, për barnat dhe materialet e tjera medicinale me afat të skaduar, ajo thotë se janë grumbulluar aty tash e gati 15 vjet. Sipas Mehajt, sasisë së tyre i kanë kontribuar edhe donacionet e bëra gjatë pandemisë Covid-19.

“Stoqet që i kemi pasur në klinika, i kemi deponuar këtu. Është një numër i caktuar, nuk mund ta them me shifra. Nuk e di saktë as cilat barna janë, por vlen të theksohet se një produkt, që në kohë të pandemisë ka qenë vështirë të sigurohet, gjendet këtu në stok me afat të skaduar”, thotë Mehaj, duke iu referuar ilaçit antiviral Remdesivir.

Ajo nuk mund të thotë se përse ky ilaç - dikur i shumëkërkuar - ka përfunduar pa afat në magazinat e barnatoret, bashkë me lloje të tjera barnash.

Ajo që dihet është se Remdesivirin, gjatë pandemisë, qytetarët e Kosovës e kanë blerë vetë nëpër barnatore, me një çmim prej 150 deri në 200 euro.

Institucionet shëndetësore vazhdimisht hedhin fajin te njëra-tjetra për keqadministrim të barnave.

Si duhet të asgjësohen barnat me afat të skaduar?

Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon disa hapa - përfshirë kthimin te prodhuesi, groposjen, zbrëthimin

kimik dhe djegien - për asgjësimin e sigurt të barnave me afat të skaduar.

Sipas saj, këto barna “duhet të asgjësohen në mënyrë të sigurt, pa dëmtuar njerëzit dhe mjedisin”.

Mehaj thotë se barnat pa afat nuk janë tërhequr nga Barnatorja Qendrore e QKUK-së për asgjësim qysh në vitin 2010. “Ekzistojnë procedura standarde operative se si një institucion duhet t’i tërheqë ose asgjësojë barnat. Një institucion si QKUK-ja nuk mund ta bëjë vetë një gjë të tillë. Ajo shkon përmes Ministrisë së Shëndetësisë, e cila duhet të hapë një tender për këtë çështje”, thotë Mehaj.

Në një udhëzim administrativ, të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës qysh në vitin 2008, thuhet po ashtu se Ministria e Shëndetësisë është ajo që kontrollon dhe mbikëqyr administrimin e mbeturinave të produkteve medicinale, të gjeneruara në institucionet shëndetësore publike dhe private.

Ministria udhëzon edhe për mënyrën e shkatërrimit të mbeturinave të produkteve medicinale, thuhet në dokument. E kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, kjo ministri tha se ka formuar tashmë një grup punues për asgjësimin e mbetjeve mjekësore.

“Grupi e ka për obligim hartimin e kriterëve për asgjësimin e këtyre mbetjeve medicinale dhe pas përfundimit të kësaj çështjeje, do të fillohet me aktivitetin e prokurimit”, thuhet në përgjigjen me shkrim.

Ministria nuk iu përgjigj pyetjeve shtesë të REL-it se kur është formuar ky grup punues, përse barnat me afat të skaduar nuk janë asgjësuar tash e sa vite dhe a paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve grumbullimi i tyre.

Farmacista Sabrije Fazliu-Asllani thotë se ruajtja e barnave me afat të skaduar në një vend ku ka edhe barna të përdorshme, bart rrezik për këto të fundit. “Barnat e skaduara kontaminojnë ambientin apo vendin ku i lëmë”, thotë ajo.

Fazliu-Asllani, e cila drejton një barnatore private në Prishtinë, tregon se largimin dhe asgjësimin e barnave me afat të skaduar në institucionet private, e bëjnë kompanitë furnizuese.

Kosova nuk ka një vend të veçantë publik për asgjësimin e këtyre produkteve.

Por, Ministria e Mjedisit, Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor prej vitesh ka licencuar së paku dy kompani private, të cilat, pos tjerash, janë të thirrura edhe për

asgjësimin e mbetjeve medicinale dhe ilaçeve me afat të skaduar.

Këtë proces ato e kryejnë në furra me temperatura të larta brenda punëtorive të tyre.

Radio Evropa e Lirë ra në kontakt me pronarin e një kompani, i cili tha se, aktualisht, nuk është duke u marrë me punë të tilla, pasi nuk ka pasur ndonjë ofertë ose tender për asgjësim barnash. “Para pak vitesh kemi bërë asgjësimin e disa mbetjeve medicinale në një komunë”, tha shkurtimisht ai, pa dhënë më shumë detaje.

Barnatorja Qendrore e QKUK-së, që udhëheq Mehaj, është e stërmbushur edhe me tavolina pune për stafin, për shkak të mungesës së hapësirave. “Jemi shumë ngushtë dhe kjo na krijon probleme. Ne, edhe kur kemi furnizime të rregullta, duhet të koordinohemi për të liruar hapësira”, thotë Mehaj.

Situata, sidoqoftë, nxjerr në pah një paradoks shqetësues në sistemin e kujdesit shëndetësor të Kosovës, ku pacientët shpesh detyrohen të blejnë barna me paratë e tyre, ndërkohë që barnat e skaduara grumbullohen nëpër barnatore.

Adresimi i çështjes duket se është kritik për ruajtjen e shëndetit publik.



Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë në mes të Kosovës dhe Republikës së Letonisë do të avancohet

PRISHTINË, 3 TETOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ditën e dytë të vizitës në Letoni e filloi në një takim me sekretaren për Bashkëpunim të Jashtëm dhe Strategji të Ministrisë së Drejtësisë, Kristine Pommere.

Letonia është shembull i jashtëzakonshëm për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë andaj edhe

ekspertiza e tyre është më se e nevojshme për hapat tutje të vendit tonë drejt këtij procesi. Ministria Haxhiu falënderoi Pommere për mbështetjen e vazhdueshme, veçanërisht për ekspertizën që Ministria e Drejtësisë ka marrë nga dy ekspertë letonezë gjatë dy viteve të fundit.

Anëtarësimi në EUROJUST, mbështetja në rrugëtimin tonë

për integrim evropian si dhe ekspertiza në zhvillim të politikave janë çështjet kryesore në të cilat u zhvillua diskutimi i përbashkët.

Pommere tha se Kosova është partnere e nevojshme dhe e respektuar për Letoninë andaj edhe përkushtimi për forcim të raporteve, bashkëpunim dhe mbështetje strategjike do të avancohet.



Kosova, pas presionit të Gjermanisë, në prag të rikthimit të mallrave nga Serbia

PRISHTINË, 3 TETOR - "Ne po punojmë dhe jemi të përkushtuar që 10-vjetori i Procesit të Berlinit të jetë i suksesshëm". Kështu iu përgjigj Qeveria e Kosovës pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse është duke shqyrtuar kërkesën e Gjermanisë për heqjen e ndalimit të importit të mallrave nga Serbia.

Ambasada e Gjermanisë në Kosovë konfirmoi për REL-in se "ka pasur shumë bisedime mes zyrtarëve gjermanë dhe kosovarë për këtë temë" sepse, siç tha, "Gjermania do që të arrijë rezultate sa i përket CEFTA-s në samitin e këtij viti të Procesit të Berlinit".

Kërkesën për heqjen e ndalesës së importit të mallrave nga Serbia në Kosovë e bëri i dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, në fillim të shtatorit, me shpjegimin se kjo ndalesë bllokoi punën e CEFTA-s, apo Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Ai tha se, për shkak të kësaj ndalesë, Kosova mund ta rrezikojë pjesëmarrjen në Procesin e Berlinit - një nismë që synon ta ndihmojë zhvillimin ekonomik të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe afrimin e tyre me Bashkimin Evropian.

Samiti i dhjetë të Procesit të Berlinit do të mbahet më 14 tetor.

Qeveria e Kosovës mori vendim për t'i ndaluar importet e mallrave nga Serbia në mes të korrikut të vitit 2023, për, siç tha, arsye sigurie.

Atëkohë, policia serbe arrestoi tre policë të Kosovës. Edhe pse ata, ndërkohë, u liruan, vendimi për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia mbeti në fuqi.

BE-ja ka deklaruar në disa raste se një vendim i tillë i autoriteteve të Kosovës është në kundërshtim me marrëveshjen CEFTA dhe në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim të Kosovës me BE-në.

Ministria e Punëve të Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, tha më 1 tetor, në një konferencë



përgatitore me ministrat e Jashtëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor, se dy javët e ardhshme janë vendimtare për mbajtjen e sukses të samitit të Procesit të Berlinit.

"Varet nëse do të arrihet ndonjë marrëveshje për zbatimin e CEFTA-s. Ka ende punë për ta arritur këtë", tha ajo.

Ekspertët mbështesin heqjen e masave që ndalojnë importet nga Serbia

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë për Radion Evropa e Lirë se vendimi për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia është marrë për arsye sigurie më shumë se një vit më parë dhe se është koha që të shqyrtohet seriozisht shfuqizimi i tij.

Ai thotë se ky vendim rrezikon jo vetëm punën e CEFTA-s, por edhe Procesin e Berlinit dhe Tregun e

Përbashkët Rajonal, për të cilin u dakord në vitin 2020. "Të gjitha janë të lidhura me njëra-tjetrën. Prandaj, është e rëndësishme që të largohen të gjitha pengesat, jo vetëm nga Kosova... Ne kemi probleme edhe me eksportimin e mallrave në Serbi, sepse ajo nuk e njeh dokumentacionin fitosanitar të Kosovës", thotë Rafuna.

Me të pajtohet edhe ekonomisti Safet Gërxhaliu, i cili thotë se Qeveria e Kosovës nuk duhet të "eksperimentojë" në bashkëpunim ekonomik rajonal. Sipas tij, Kosova duhet ta kuptojë rëndësinë e integritimit ekonomik evropian dhe ajo nuk e ka "luksin" ta bllokojë bashkëpunimin rajonal me vendime politike.

Rafuna: Investitorët e shohin rajonin si një treg

Rafuna, i cili është edhe kryetar i bordit drejtues të odave ekonomike të Ballkanit Perëndimor, thotë se të gjitha nismat rajonale janë të rëndësishme, andaj çdo pengesë që ndikon në funksionimin e tyre, duhet të hiqet. "Ne jemi një vend i vogël, jemi një treg i vogël dhe të gjithë investitorët e shohin rajonin si një treg. Është e rëndësishme që mes nesh të mos ketë pengesa. Ato nuk janë mesazh i mirë për investitorët", vlerëson ai.

Tregu në vendet e Ballkanit Perëndimor ka rreth 18 milionë banorë.

Qëndrim të ngjashëm shpreh edhe ekonomisti Gërxhaliu, i cili shton se CEFTA ka një rëndësi të madhe për biznesmenët, për shkak të përfitimeve doganore dhe plasimit të mallrave.

Ai nënvizon se edhe Procesi i Berlinit është një iniciativë e rëndësishme, nga e cila përfitojnë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe se Kosova, në asnjë mënyrë, nuk duhet të lejojë që të përjashtohet. "Nuk mund të presim investime të huaja nëse nuk ka stabilitet politik. Ai stabilitet politik nuk mund të arrihet nëse nuk kemi pjesëmarrje aktive në të gjitha nismat rajonale", thotë Gërxhaliu.

Procesi i Berlinit u krijua në vitin 2014 në Berlin, me iniciativën e kancelares së atëhershme gjermane, Angela Merkel, si një kontribut në perspektivën e zgjerimit të BE-së.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian, janë pjesë e Procesit të Berlinit: Kosova, Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Shqipëria.

Disa nga marrëveshjet e nënshkruara mes këtyre vendeve, si pjesë e Procesit të Berlinit, janë:

marrëveshja për njohjen reciproke të kartave të identitetit, të diplomave universitare, të kualifikimeve profesionale, pastaj bashkëpunimi në fushën e transportit, energjisë, ekologjisë, digitalizimit dhe në roaming.

Kosova është anëtare e CEFTA-s që nga viti 2007, por është e përfaqësuar përmes misionit të OKB-së në vend - UNMIK. Qeveria e Kosovës ka kërkuar që ky përfaqësim i Kosovës të ndryshohet, ndërsa Gjermania ka ofruar "zgjidhjen" në këmbim të heqjes së ndalesës për importin e mallrave nga Serbia.

Sarrazin i tha Rrjetit Ballkanik të Kërkimeve - BIRN, më 23 shtator, se pranë emrit të Kosovës do të kishte një yll, ose një fusnotë, që tregon se statusi i Kosovës nuk është zgjidhur përfundimisht.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, vizitoi këtë javë Gjermaninë, ku kërkoi mbështetjen e këtij vendi për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës, BE-ja dhe NATO-ja.

Përmes një postimi në platformën X, Ministria e Punëve të Jashtme e Gjermanisë tha se e përkrah Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së dhe theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes së Kosovës në nismat rajonale, ashtu si edhe të normalizimit të marrëdhënieve të saj me Serbinë.

Sa eksporton Kosova në vendet e CEFTA-s?

Nga viti 2019 e këndej vlera e produkteve që Kosova ka eksportuar në shtetet anëtare të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) ka arritur në rreth 1.6 miliard euro. Përveç Kosovës, pjesë të CEFTA-s janë: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnje e Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia.



Rreth 100 drejtues të kompanive lidere gjermane marrin pjesë në Forumin e Dytë Ekonomik Gjermano-Kosovar

PRISHTINË, 3 TETOR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka marrë pjesë në Forumin e Dytë Ekonomik Gjermano-Kosovar, që ka sjellë në Kosovë rreth 100 drejtues të kompanive lidere gjermane, i organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare. Në këtë forum janë diskutuar

zgjidhje për energjinë, teknologjinë dhe industrinë, si dhe përpjekjet për përfortimin e lidhjeve ekonomike mes dy vendeve dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim.

E para e ekonomisë potenciale se një shembull i suksesshëm i kalimit drejt energjisë së qëndrueshme është ankandi

për një central energjetik fotovoltaik (PV) prej 100 MW, i cili rezultoi me një çmim 35 % më të ulët se çmimi maksimal. "Ky është vetëm fillimi, pasi shumë shpejt do të pasojë ankandi i ardhshëm për energjinë e erës prej 150 MW, që do të avancojë më tej qëllimet tona për energjinë e ripërtërishtme", shtoi ajo.

Keqardhja e Lasgushit: Kur u kthye nga Parisi, kolegët nuk rrinin me Enverin – e quanin ‘tutkun’!

A është takuar poeti Lasgush Poradeci, me Enver Hoxhën? Sa të vërtetë ka në kujtimet që gruaja e diktatorit, Nexhmije Hoxha, propagandoi pas vdekjes së tij, mbi marrëdhëniet e dhembshurisë e dashurisë të Enverit, për shkrimtarë e artistë. Ismail Kadare, në një intervistë disa vite më parë, shprehej: “Dikush si Lasgush Poradeci, do të dridhej në varr, po të lexonte, se ç’shkruset për të. Poeti më i madh i gjallë i krejt epokës, jetoi 40 vjet si i vdekur, kaq shumë ishte i mënjanuar, i ndaluar, i shtypur me këmbë. Kurse zonja Hoxha, përpigjet të na mbushë mendjen, se sa shumë e donte Enveri e, sa shpesh interesohej për të”!


Në librin me kujtime; “Të vërteta e të pathëna për Lasgushin”, botim i vitit 2000, bashkëkohësi dhe miku i poetit, Tomi Mato, ishte dëshmitar i mos takimit mes Lasgushit dhe Enverit, në vitin 1983. Në këtë rrëfim, jepet dhe varianti sipas poetit, i takimeve të hershme, kur Enver Hoxha, nuk ishte bërë ende diktator dhe kur në Liceun e Tiranës, e kishte dalluar mes të rinjve, për kompleksin e tij të inferioritetit. Një ditë e gëzueshme vere në Volorekë (Drilon). Banorët dhe familjet e tyre, drekojnë nën hijen e pemëve. Mes tyre Lasgushi me të bijën, hequr pak mënjanë. Me vete një shishe vere, holluar me ujë burimi. Nuk e dinte kush, se nga çasti në çast, aty do t’ia behte udhëheqësi me të shoqen, nga pas eskorta. Ishte vera e vitit 1983. Kjo ditë i kujtohet mirë Tomi Matos.

Ndërsa turma zuri të këndoje “Enver Hoxha e mprehu shpatën!” dhe të bërtasë “Parti-Enver, jemi gati kurdoherë”, njerëzit dyndeshin, kush e kush t’i shtrëngonte atë dorë, ndërsa

truprojat shtynin, t’i hapnin udhë “kalorësit”.

Të dy me bastun në dorë, të vjetër boll. Me të dëgjuar lajmin dhe brohoritë e turmës, Lasgushi u veçua nga turma, por nuk është larguar. Nuk është menduar gjatë, të rrijë apo të ikë, pasi askujt nuk kishte për t’i hedhur fije dyshimi, kishte apo nuk kishte dëshirë ai, të takonte Enverin. Në euforinë e turmës ndokush, mund të mendonte se ky reagim ishte normal, për natyrën e tij flagrante, të ftohtë e kapriçoze. Por, askush, as kishte parë, as kishte dëgjuar. Vera e vitit 1983, ishte i vetmi shans publik, ku ata të dy janë ndodhur spontanisht, në të njëjtin vend, njëri mes turmës, tjetri jashtë saj. Poeti i ka hedhur sytë dhe e ka lënë në hall të vet, megjithëse vështirë ta dallojë, në atë dalli. “Enveri dhe Lasgushi, pushuan për 20 vjet bashkë në Pogradec dhe një kafe, nuk e pinë bashkë”, shkruan Tomi Mato.

Pikërisht pas kësaj dite, ai e kishte pyetur poetin, nëse ishin takuar ndonjëherë pas çlirimit. Në vend të komenteve, Lasgush Poradeci i kishte rrëfyer, fabulën e thjeshtë të njohjes me këtë “qerrata”, 43 vjet më parë, në Liceun e Tiranës. “U njohëm në gjimnazin e Tiranës, në vitin 1937. Unë isha 12 vjet më i madh, isha më i shkolluari, kurse Verua [Enveri], erdhi nga Parisi, ashtu ‘tabula rasa’. Kolegët e tallnin: ‘Tutkun’, i thoshin. ‘Të kanë vajtur këmbët, e jo koka në Paris. T’i shtrydhën trutë putanat!’ Mua më vinte keq. E shoqëroja, më kupton, më vinte keq, ndaj e shoqëroja, se të tjerët i ishin larguar. Një ditë, se ku i kishte gjetur dy librat e mi, ‘Vallja e yjeve’ dhe ‘Ylli i zemrës’. Më tha disa vjersha përmendësh prej tyre dhe m’u lut, t’i shkruaja diçka me dorën time në libër dhe ai ta



kishte si kujtim, nga njeriu që iu gjind, kur të tjerët iu larguan. Ia shkrojta. Ai më përqafoi dhe më ftoi për darkë në shtëpi. Tri herë më ftoi, por nuk i vajta”!

Ky ishte rrëfimi që Lasgushi, i kishte bërë autorit Tomi Mato, më 1983, dhe dy vjet më pas, Enver Hoxha vdes. Por, është bashkëshortja (Nexhmija), besnike pas vdekjes, ajo që rishikon e kujdeset për kultin e të shoqit, aty ku vetëm nëpërmjet hipnozës ai mund të rrezikohej seriozisht. Dhe, ishin mendjet intelektuale, ato që ishin kërcënuar e kishin pasur presionin më të lartë prej tij, ato nga çasti në çast, mund të shpërthenin.

Kur Pallati i Kulturës së Pogradecit, do të merrte emrin “Lasgush Poradeci”, pas vdekjes më 1987, në muzeun e qytetit, vjen një letër nga Nexhmije Hoxha, me titull: “Nga kujtimet e shokut Enver, për Lasgush Poradecin”.

Aty shkruhej: “U interesova për Lasgushin, pranë shokëve të

Partisë dhe më thanë se është mirë me shëndet! E kam njohur para lufte, kur isha profesor në gjimnazin e Tiranës! Ai ishte i dëshpëruar nga regjimi i Zogut, prandaj preferonte të jetonte i vetmuar. Dikur dilte dhe bashkohej me ne”!

Por, për habinë e atyre që e njihnin situatën, letra mbante datën 28 gusht 1981 dhe po bëhej e njohur, kur njeri kishte vdekur vërtet, ndërsa vepra e poetit, bashkë me të dhe ai vet, sapo kishte nisur të jetonte.

Lasgush Poradeci, ishte njohës i mirë i gjuhës gjermane, përveç faktit që kishte përkthyer prej saj vepra, nga Gëte, Shiler, Hajne. Si e kurdisur deri në këtë pike, censura ndaj tij, edhe takimet me artistë gjermanë që vizitonin Pogradecin, i ishin ndaluar në momentin e fundit. Në rrëfimin e Tomi Matos, “Përse nuk e takoi Peter Oberi, Lasgush Poradecin?” – një mik i poetit në vitet e studimit në Gracë, Austri, thuhet se si nuk “mundën” të takohen. Lasgushi kishte këmbëngulur dhe e kishte pritur mikun në “kullën” e tij. Por, Sekretari i Parë dhe Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të rrethit, kishin nxjerrë arsye shëndetësore të Lasgushit, që si kokra e mollës priste mikun nga çasti në çast. Peter Ober “u bind se Lasgushi nuk mund të priste, por as nuk bën dot vizita”, ndërsa me keqardhje kishte thënë: “I uroj shëndet mikut tim të zemrës. Jemi pleq. Desha ta takoj e të bashkëpunoja me të, pasi kam respekt për penën e tij. Është i madh. Keq më vjen që nuk u takuam në këtë botë. Mbase do ta takoj në botën tjetër”!



Në vitin 1978, në Pogradec kishte ardhur një trupë artistësh gjermanë. Gjatë shfaqjes së tyre, u kishte bërë përshtypje në radhë të parë, plaku me kone të bardhë, që

thërriste “Bravo, bravo”! Nga kurioziteti, kishin mësuar se ai ishte poeti më i madh, i gjallë shqiptar. Të nesërmen kur kishin rënë dakord të piqeshin të dyja palët, takimi i tyre ishte anuluar. Nga dufi Lasgushi ishte shprehur: “Këta qeveritarët më shikojnë si budalla, si armik dhe jo si një pogradecar akademik. Çudi! Pse e kanë krijuar këtë opinion?! Më hipën nga njëherë që të vete në zyrë dhe t’u lëshohem ashtu vençe. Po unë s’e turpëroj, por e nderoj Pogradecin”!

Ishte stina që e gjente në shtëpinë e Tiranës. Atë ditë mbushte 80 vjeç. Miq shkrimtarë e kishin vizituar gjatë gjithë ditës, ndërsa të nesërmen, do të zhvillohej ceremonia në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve. Ajo ditë, përshkruhet nga Tomi Mato, i pranishëm me një grup pogradecarësh, në shtëpinë e poetit. “Troket dera. Nafija e hapi dhe hyn Luigj Mazi (administrator i Lidhjes). Pasi u përshëndet me Lasgushin dhe me ne, ai filloi të flasë me një ndrojtje dhe trishtim, që nuk të sillte optimizëm: ‘Më ka dërguar Lidhja, t’ju njoftoj zoti Llazar, se nesër për arsye sekrete, anulohet ceremonia e festimit të 80-vjetorit të datëlindjes suaj! Kaq tha dhe iku’! Por, Lasgushi, që nuk e ndërronte me asgjë këtë moment miqsh, që e kishte pagëzuar ‘Barku i Shën Mërisë’, as me festën e Lidhjes, kishte bërë ‘Gëzuar’ me raki e këngë.

Kur poeti mbylli sytë, më 13 nëntor 1987 dhe trupi i tij kishte udhëtuar nga Tirana në Pogradec, “nga lart” ishte dhënë urdhër se nuk duhej të kishte ceremoni “të tepërta” nga pogradecarët, nga ata që Lasgushi i kishte quajtur në gëzim e sipër “Barku i Shën Mërisë”. Të gjitha adetet, ishin bërë në Tiranë. /Memorie.al/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

FHK-ja fiton të drejtën e organizimit të një tjetër ngjarjeje ndërkombëtare

PRISHTINË, 3 TETOR - Bashkëpunimi shembullor në mes të Federatës së Hendbollit të Kosovës dhe Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit është konfirmuar edhe një herë. IHF-ja ia ka besuar Federatës së Hendbollit të Kosovës organizimin e një tjetër ngjarjeje

të rëndësishme. Bëhet fjalë për IHF Trophy për Zonën Evropiane për hendbollistët e grupmoshës U18 dhe U20. Kjo ngjarje, që pritet të grumbullojë mbi dhjetë ekipe kombëtare, do të mbahet prej 13 deri më 19 janar të vitit të ardhshëm. Kampionati IHF Trophy është

kualifikues për Botëror dhe kjo e bën edhe më të rëndësishëm. Ka shumë vjet që FHK-ja shquhet me organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare të hendbollit. Kampionatin IHF Trophy tashmë e kemi organizuar shumë herë dhe vlerësimet e Federatës Ndërkombëtare ishin

vazhdimisht në superlativ. Sivjet në Prishtinë janë organizuar dy kampionate evropiane të grupmoshave të reja dhe EHF-ja ka vlerësuar FHK-në për punën e kryer. Përmes IHF Trophy ekipet e Kosovës janë kualifikuar dy herë në Kampionat Botëror. Ky është synimi kryesor edhe për



ngjarjen që do ta organizojmë në janar bashkë me partnerët tanë besnikë.

Zhegrova pasi ia në hije yjet e Realit: Dallimin e bëri shpirti i ekipit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 TETOR - Ylli i reprezentacionit të Kosovës, Edon Zhegrova, ka shkëlqyer të mërkurën në mbrëmje në përballjen që Lille e zhvilloi kundër Real Madridit (1-0). Pas paraqitjes fantastike, Zhegrova është shpallur lojtar i ndeshjes, duke lënë në hije yje të futbollit botëror si Vinicius Jr, Bellingham apo Mbappe.

Futbollisti "dardan" suksesin ia atribuoi ekipit, derisa bëri me dije se synim kanë që edhe në ndeshjen e radhës të fitojnë. "Mendoj se dallimin e bëri shpirti i ekipit. Të gjithë dhanë gjithçka, në çdo pozicion. Trajneri na e kërkoi këtë, pasi kjo ishte e vetmja mënyrë për t'i bërë ballë një ekipi

të madh si Real Madridi. Ne duhet të vazhdojmë kështu, me të njëjtin mentalitet, me të njëjtin shpirt. Shpresoj që të shkojmë sa më larg, por e dimë që Liga e Kampionëve është një vitrinë e madhe me klube të mëdha, por ne do të përpiqemi të fitojmë edhe ndeshjen e radhës", ka thënë Zhegrova.

Suksesit të Zhegrovës ia ka gëzuar edhe Federata e Futbollit e Kosovës që ka reaguuar pas ndeshjes fantastike që Zhegrova e zhvilloi ndaj "Mbretërve" të Madridit. "10-shi i Kombëtares së Kosovës mbrëmë u shpall 'Lojtari i ndeshjes' në përballjen e ekipit të tij, LOSC Lille, kundër klubit mbretëror Real Madrid, në kuadër të garës më të madhe të klubeve, Ligës së Kampionëve, të cilën e fituan me rezultat 1-0. Zhegrova në



këtë ndeshje luajti për 90 minuta dhe ishte lojtari kyç në fitoren e rëndësishme të ekipit të tij, me 62 prekje me topin, 88 % saktësi të

pasimeve dhe shtatë duele të fituara", thuhet në postimin e FFK-së. Raportet e Zhegrovës me

Federatën e Futbollit nuk janë në nivel të kënaqshëm, pasi ai u përjashtua për ndeshjen ndaj Qipros, dhe për këtë Zhegrova ditë më parë e fajësoi FFK-në.

Edhe Ambasada e Francës në Kosovë e ka përgëzuar paraqitjen e ekipeve franceze në Ligën e Kampionëve në këtë edicion. Ambasada Franceze në Kosovë përmendi edhe faktin se ylli Edon Zhegrova u shpall lojtar i ndeshjes. "Është historike: 4 klube franceze po garojnë në fazën e ligës në Ligën e Kampionëve, duke e përfshirë Lillen, i cili e bëri një sukses të madh mbrëmë duke dominuar ndaj Real Madridit, kampionit në fuqi të Evropës. Bravo! Edon Zhegrova, lojtari i ndeshjes, pas dy javësh në Prishtinë", shkoi Ambasada Franceze në Kosovë në rrjetin social "X".

Lenjani i jep fund karrierës me Shqipërinë: Realizim i ëndrrës së fëmijërisë

TIRANË, 3 TETOR - Ermir Lenjani i ka dhënë fund karrierës së shkëlqyer me Kombëtaren e Shqipërisë pas 10 viteve duke veshur fanellën kuqezi. Mbrojtësi shqiptar që tani aktivizohet me fanellën e skuadrës zvicerane Schaffhausen ishte pjesë e Kombëtares shqiptare nga viti 2013 deri më 2023. Në 44 ndeshje të luajtura për kuqezinjtë, Lenjani ka shënuar pesë gola dhe ka asistuar në një tjetër. "Dua t'ju njoftoj se kam vendosur të tërhiqem nga Kombëtarja shqiptare. Një vendim aspak i

lehtë, por besoj se është momenti i duhur. Për mua ka qenë gjithmonë nder dhe përgjegjësi e madhe ta vesh fanellën e kombit tim. Jam shumë krenar që emri im është pjesë e historisë së futbollit shqiptar dhe që ëndrra ime e fëmijërisë u realizua në vitin 2016, ku bëmë krenar kombin kuqezi me përfaqësimin historik për herë të parë në një Kampionat Evropian. Kam plot momente të bukura me fanellën kuqezi, që nga debutimi në ndeshjen ndaj Bjellorusisë, te goli i parë në



'Elbasan Arena' ndaj Danimarkës, fitorja historike në 'Francë 2016' ndaj Rumanisë dhe grumbullimi im i fundit në muajin mars 2023 me Kombëtaren, ku nisi edhe

rruga drejt kualifikimit në 'Euro 2024', ka thënë Lenjani. "I jam falënderues Zotit, familjes time dhe çdo personi që më ka qëndruar pranë në çdo moment. Çdo fillim e ka një fund dhe rrugëtimi im nuk do të ishte i mundur pa trajnerët Gianni De Biasi, Christian Panucci, Edoardo Reja dhe Sylvio Mendes Campos Júnior, të cilët dua t'i falënderoj nga zemra për besimin e dhënë. Gjithashtu, dua të falënderoj stafin teknik të Kombëtares, Federatën Shqiptare të Futbollit, Presidentin

Armand Duka dhe të gjithë shokët e skuadrës që më kanë mbështetur në rrugëtimi më të veçantë të jetës time. Në fund, falënderimi im më i madh është për tifozët e Kombëtares shqiptare. Në çdo stadium në Shqipëri dhe në Evropë jemi ndjerë si në shtëpinë tonë, falë jush, tifozët më të mirë në botë. Tani e tutje jam si të gjithë ju, gjithmonë krah Kombëtares shqiptare dhe djemve kuqezi. Faleminderit nga zemra shqiptarë! Një kapitull i mbyllur, por një rrugë e përjetshme!", ka shtuar Lenjani.

Zvicra fton Xhakën dhe Zeqirin për ndeshjen kundër Serbisë

CYRIH, 3 TETOR - Dy shqiptarë në listën e Kombëtares së Zvicrës kundër Serbisë. Kapiteni Granit Xhaka dhe Andi Zeqiri do të jenë ata që do të udhëtojnë drejt Beogradit më 12 tetor. Selektori Murat Yakin e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për këtë përballje të nxehtë. Përballjet mes helvetikëve dhe serbëve janë çdoherë të nxehta shkaku i

futbollistëve shqiptarë. Në vitin 2022, në Kupën e Botës në Katar, Granit Xhaka ishte i përfshirë në incident shkaku i provokimeve dhe sulmit nga ana e ekipit serb. Derisa në vitin 2018 po në Kupën e Botës, veçse atëherë në Rusi, Xherdan Shaqiri dhe Granit Xhaka, ata që e mposhtën Serbinë me golat e tyre. E veçanta e kësaj ishte se të dy

festuan duke bërë me dorë shqiponjën.

Lista e futbollistëve: G. Kobel, P. Kohn, Y. Mvogo, M. Akanji, N. Elvedi, U. Garcia, B. Omeragic, R. Rodriguez, S. Widmer, C. Zesiger, M. Aebischer, Z. Amdouni, B. Embolo, E. Fernandes, R. Freuler, J. Monteiro, D. Ndoje, F. Reider, V. Sierro, F. Ugrinic, Ch. Witzig, G. Xhaka, D. Zakaria, A. Zeqiri.



Nagelsmani shpall listën e Gjermanisë, rikthehen Gnabry dhe Rudigeri

BERLIN, 3 TETOR - Më 11 tetor Gjermania udhëton drejt Bosnjë-Hercegovinës, ndërsa tri ditë më pas pret në shtëpi Holandën për t'i zhvilluar takimet e radhës të vlefshme për Ligën e Kombeve. Për këto dy takime komisar teknik i Gjermanisë ka shpallur listën e

të grumbulluarve, e cila pritej me shumë kureshtje pasi me publikimin e saj janë shuar disa pikëpyetje. Kështu në portë konfirmohet fakti se Janis Blasvish do të jetë portieri i tretë. Në këtë listë spikat edhe prania e Gnabry. "Sergie ka kaluar një periudhë të keqe

vitin e kaluar pasi ka pësuar shumë dëmtime dhe për rrjedhojë humbi edhe formën. Tani e kam vënë re se po rikuperon mjaft mirë pasi prej muajsh po luan mirë dhe nuk po dëmtohet", ka thënë Julian Nagelsmann, trajneri i Kombëtares gjermane. Lista e

futbollistëve: O.Bauman, J. Blasvish, A. Nubel, W. Anton, B. Henrichs, J. Kimich, R. Koh, M. Mitelshted, D. Raum, A. Rudiger, N. Schloterbeg, J. Tah, R. Andrich, Ch. Fyhrish, P. Gross, J. Musiala, A. Pavloviq, A. Shtiler, F. Wirtz, S. Gnabry, K. Haverz, D. Undav, T.



Alonso: Synoj titullin e tretë, pas Formula 1 do të garoj në Dakar

MADRID, 3 TETOR - Me dy tituj kampionë në Formula 1 dhe në moshën 42-vjeçari, piloti spanjoll i Aston Martin, Fernando Alonso, është ende një konkurrent i fortë. Madje ai synon ta fitojë titullin e tretë për pilotë pavarësisht se suksesi i tij i fundit në F1 daton në vitin 2023, kur garonte me Ferrari. 8 podiumet e fituara vitin e kaluar me Aston Martin kanë hequr çdo dyshim në lidhje me aftësitë e tij. Alonso është ende ndër pilotët më të fortë dhe ekipi britanik ka zgjedhur ta mbajë pranë, duke zgjatur kontratën e tij për të paktën edhe dy vjet të tjera. Alonso shpreson që ardhja e Adrian Newey do t'u japë një shtysë të re ambicieve të Aston Martin dhe të tij. Alonso foli për të ardhmen e tij të afërt dhe të largët. "Është e qartë se Triple Crown është shumë tërheqëse për mua. Domethënë, fitimi i një garë të Formula 1 në pistën e Montekarlo, fitorja në garën 24-orëshe të Le Mans dhe



triumfi në Indy500. Me këtë të fundit u përpoqa tre herë dhe dështova". Përpijekja nuk është më në planet e mia, të paktën për momentin. Jam shumë i fokusuar në F1. Në dy ose tre vitet e ardhshme dua të fitoj një titull të tretë botëror për pilotë. Aktualisht është prioriteti im i parë dhe i vetëm. Pas kësaj do të jem 45-46

vjeç dhe do të shohim si do të jem", u shpreh Alonso. Duke folur për të ardhmen, shtoi: "Kam synime të tjera. Sfida ime e radhës do të jetë Rally Dakar. Nëse do të mund ta fitoja, do të isha jashtëzakonisht i kënaqur. Si pilot, të jesh në gjendje të fitosh në Endurance, në Le Mans dhe Daytona, në F1 dhe më pas edhe në Rally do të thotë shumë".

Red Bulli bën ndryshimin e madh, një femër do të vendosë strategjitë e garës së pilotëve

MILTON KEYNES, 3 TETOR - Red Bull Racing po kryen një proces të madh ndryshimi në radhët e veta, teksa mjaft emra të njohur në pozitat drejtuese janë larguar. Gjithsesi, te makina kampione nuk janë shqetësuar për lamtumirën e fundit në mes të teknikëve, shumë prej të cilëve kanë kaluar te McLaren. Sipas medieve, në postin e shefit të strategjisë do të emërohet Hannah Schmitz. Një inxhinierë 39-vjeçare, e cila do ta zëvendësojë Will Courtenay. Ai që konfirmoi lëvizjen është Helmut Marko: "Ndryshimet janë një evolucion normal, sepse kur je kaq i suksesshëm atëherë njerëzit largohen. Por Hannah mund ta marrë atë rol". Schmitz ka një diplomë në inxhinieri mekanike nga Universiteti i Kembrixhit. Që nga viti 2009 ai ka qenë pjesë e botës së Red Bull Racing, duke filluar si një "student i brendshëm", më pas duke u bërë një figurë kyçe në sektorin e



lidhur me strategjitë që do të adoptohen në garë. Tashmë ka fituar përvojën e duhur dhe është gati për ta bërë hapin e madh. Një grua që reflekton qetësi dhe leadership e guxim në marrjen e vendimeve të pakëndshme në situata të komplikuar. Intuitat fituese e bënë Schmitzin të famshëm në qendër të vëmendjes në vitin 2022. Koha e ndalimit në pit

në Montekarlo atë vit ishte perfekte, duke i dhënë Sergio Perezit fitoren dhe Max Verstappenit një vend të tretë të çmuar. Kryevepra më e madhe, megjithatë, mbetet GP e Hungarisë, sërish në vitin 2022: Hannah sugjeroi vendosjen e gomave të buta në Red Bull të holandezit, i cili nisi i dhjetë. Red Bull do të fillojë nga ajo për të mos ndalur së fituari.

SHKURT

Fitorja e parë për Kastriotin

Kastrioti e ka shënuar fitoren e parë në edicionin 2024/2025 të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Në Shtime, Kastrioti fitoi ndeshjen e mbetur të xhiros së parë ndaj Vjosës. Kjo ndeshje ishte shtyrë për shkak të angazhimeve evropiane të klubit ferizajas. Kastrioti fitoi me rezultat 40:29.

Skuadra mysafire nisi shkëputjen në pjesën e parë, ndërsa në të dytën epërsia shkoi deri në 12 gola. Deniz Terziqi i shënoi 12 gola për Kastriotin. Tetë i kishte Besnik Bytyqi. Pesë gola i shënoi Lulzim Shabani e katër Gentrit Brahim. Festim Mustafa i realizoi 10 gola për Vjosën. Nga pesë i kishin Sinisha Pavlov e Stefan Kocharov. Vjosa e pësoi humbjen e parë, pas dy fitoreve. Kastrioti ka një fitore e një humbje. Nuk e ka luajtur ende ndeshjen e xhiros së dytë ndaj Llapit.

Ancelotti: Lille e meritoi fitoren

Real Madridi është mposhtur nga Lille në Ligën e Kampioneve (1-0). Pas kësaj humbje, trajneri Carlo Ancelotti nuk e fshehu zhgënjimin e madh për këtë humbje. "Çfarë ndodhi? Ndodhi ajo që ata e merituan, luajtën më mirë. Ne hasëm shumë vështirësi të futeshim në lojë. Krijua raste vetëm në fund me topa të gjatë. Ekipi nuk ishte mirë. Asgjë nuk funksionoi. Duhet të mësojmë nga kjo humbje. Shpesh edhe humbjet mund të jenë të vlefshme. Sezoni është ende i gjatë. Duhet të përmirësohemi", u shpreh Ancelotti.

Alcarazi fiton finalen maratonë ndaj Sinnerit

Tenisti spanjoll Carlos Alcaraz fitoi 2-1 (6-7, 6-4, 7-6) ndaj italianit Jannik Sinner, pas 3 orësh e 20 minutash lojë, finalen e turneut ATP 500 në Pekin. Një finale e jashtëzakonshme mes dy tenistëve më të mirë në botë. Përballë njëri-tjetrit ishin numrat 1 dhe 2 në botë, ndaj spektakli ishte i garantuar në fushë. Sinner, që kryeson renditjen, fitoi në "tie break" setin e parë, por më pas erdhi përmbysja e spanjollit, që fitoi dy setet e tjera. Sinneri kishte mundësi ta mbyllte ndeshjen në setin e dytë, por nuk ia doli dot mbanë. "Jam i kënaqur për këtë triumf, që është shumë i rëndësishëm për mua. Arrita të gjej kënaqësinë dhe ndihem sërish i motivuar", ka thënë Alcaraz. "Sinner tregoi sërish se është më i miri në botë. Për mua, niveli që po tregon është i jashtëzakonshëm. Është një bishë dhe shpresoj që të luajmë sa më shpesh mes nesh, pasi argëtohemi në fushë", u shpreh Alcaraz.

Emery: Aston Villa mund të arrijë deri në çerekfinale të Ligës së Kampioneve

Trajneri i Aston Villas, Unai Emery, ka shprehur mendimin për fitoren 1-0 ndaj Bayern Munichut në Ligën e Kampioneve. Spanjollit ka thënë se skuadra që ai udhëheq mund të arrijë deri në tetë skuadrat më të mira në Ligën e Kampioneve. "Ne duam të jemi të qëndrueshëm në mënyrë që të luajmë rregullisht në Evropë", ka thënë Unai Emery. "Kemi luajtur shumë mirë, kemi fituar, ndoshta mund të futemi në tetëshen më të mirë. Kundër skuadrave si këto është shumë e rëndësishme të jesh i fortë. Emiliano Martinez bëri një punë të mrekullueshme, duke bërë pritje të shkëlqyera. Ne po punojmë me Duran. Aspekti më i rëndësishëm është qëndrimi i tij. Ai është gati të luajë 90, 60 ose 30 minuta. Ai është i fokusuar në çdo minutë të lojës. Sot kishim dy sulmues shumë të mirë. Ishte fantastike për të dhe për ekipin", ka shtuar Emery. Pas dy ndeshjeve në fazën e ligës, Villa ka gjashtë pikë dhe është në vendin e gjashtë në renditje.

Broja në nëntor do të jetë gati për Kombëtaren

Evertoni po pret me padurim rikthimin e Armando Brojës, sidomos në këtë situatë ku ekipi është në zonën e ftohtë në Premierë Ligë. Me pronarët e rinj, shpresat për të rregulluar këtë sezon janë ngjallur, ndërsa

kjo vlen edhe për lojtarët që janë në skuadër. Armando u huazua me të drejtën e blerjes nga Evertoni në limitet e merkatos, por pyetja që lind është: Kur do të jetë gati Armando Broja? Sipas asaj që

gazeta mëson, dëmtimi i Brojës ka një fazë rikuperimi që zgjat 10 javë, të paktën kjo është komunikuar nga stafi mjekësor i Evertonit. Armando u bashkua me klubin e ri në fillim të muajit shtator dhe me llogaritë që

bëhen, ai pritet të rikthehet në fushë në mesin e muajit nëntor, për të përmbushur kohën prej 10 javësh rikuperim. Të gjithë janë kurioz sesi do të shkojë aventura e re e tij tek Evertoni, por gjithashtu edhe tifozët

shqiptarë mezi presin që ta shohin atë në fushë me fanellën e Kombëtares. Kjo do të thotë se Broja do të jetë gati edhe për dy ndeshjet e fundit që Shqipëria do të luajë në shtëpi në muajin nëntor, më 16 dhe 19.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Ana D Clothes" SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812198762 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Ana D Clothes" D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812198762 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Ana D Clothes" L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812198762 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kreshnik Sadiku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V sh.f.m.u. " Bajram Curi " Krushe e Madhe.

- Haxhi Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. " Lekë Dukagjini" Prizren, "Berat Gjonovci " Prizren.

- Valon Kerleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Arti Maka nga Juniku shpall të pavlefshme testin e maturës dëftesën e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

☎ 044 900 978 | 045 681 898
 📍 Sallon Depilimi Lumë's Details
 📷 lumesdetails
 📍 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

